

United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



Nations Unies Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVIZIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
MË 30.10 DHE MË 2.11.2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
30.10. I 2.11. 2007. GODINE

NËNTOR – NOVEMBAR
2007

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i propozimit për shmangie të Rregullës 5.2 të Rregullores së Punës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 18 tetor 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Debat /sipas kërkesës së G/P të PDK-së/ lidhur me ofertën e Grupit Negociator për Traktatin e miqësisë dhe të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Serbisë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për kthim në ripunim të Projektligjit për punë, Projektligjit për grevat dhe të Projektligjit për organizimin sindikal.
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e Avokatit të Popullit,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për trashëgiminë kulturore.

DNEVNI RED

1. Razmatranje Zakona o izbegavanju pravila 5.2. Poslovnika,
2. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice, održane 18. oktobra 2007. god.
3. Vreme za poslanička pitanja,
4. Rasprava (na osnovu zahteva P/G PDK-a) u vezi ponude Grupe za pregovore Memoranduma o prijateljstvu i saradnji između Kosova i Srbije,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Anketnoj komisiji,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o putevima,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pravima i odgovornostima poslanika,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju sukoba interesa u izvršenju javne funkcije,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o narkotičnim lekovima, psikotropnim substancama i prekursorima,
10. Razmatranje Preporuke Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu i sport u vezi Nacrta zakona za privatno obrazovanje i osposobljavanje,

11. Razmatranje Preporuke Komisije za zdravstvo, rad i socijalno staranje za vraćanje na doradu Nacrta zakona o radu, Nacrta zakona o štrajku i Nacrta zakona o sindikalnom organizovanju,
12. Razmatranje Preporuke Komisije o pitanjima pravosuđa, zakonodavstva i ustavnog okvira o imenovanju Narodnog advokata,
13. Razmatranje Preporuke Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu, omladinu i sport za imenovanje članova Kosovskog saveta o kulturnoj zaostavštini.

AGENDA

1. Discussion of the proposal for elusion of rule 5.2 of the Rule of Procedure,
2. Approval of the minutes of the plenary session held on 18 October 2007,
3. Time for parliamentary questions,
4. Debate (according to the request of P/G of PDK) regarding the proposal of the Negotiating Group on Tractate on Friendship and cooperation between Kosovo and Serbia,
5. First reading of the Draft Law on Parliamentary investigation,
6. Second reading of the Draft Law on amendment and supplement of the Law on Roads,
7. Second reading of the Draft Law on Rights and Responsibilities of a Deputy,
8. Second reading of the Draft Law on prevention the conflict of interest in exercising the public functioning,
9. Second reading of the Draft Law on narcotic medicines, psychotropic substances and precursors,
10. Discussion of the recommendation of the Committee on Education, Science Technology, Youth and Sports regarding the Draft Law on Education and Private Education,
11. Discussion of the Committee on Health, Labour and Social Welfare for reviewing the Draft Law on Labour, Strikes and Draft Law on Trade-Union organization,
12. Discussion of the recommendation of the Committee on Judicial matters, Legislation and Constitutional Framework on nomination the Ombudsperson,
13. Discussion of the Committee on Education, Science, Technology, Youth and Sport in nomination of members of the Kosovo Council for cultural inheritance.

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË MË 30.10. DHE MË 2. 11.2007

Seanca plenare filloi në orën 10,00.

Seancën plenare e kryesoi Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI KOLË BERISHA: Të nderuar deputetë, të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se të pranishëm në sallë janë 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punën e seancës së rregullt plenare.

Ju njoftoj, po ashtu, se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Numri i deputetëve të pranishëm tani është 79.

Po shoh se dëshironi ta merrni fjalën. Urdhëroni zoti Gashi!

ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ne, me shefat e grupeve parlamentare dhe me Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, sipas Rregullores së Kuvendit, e kemi përgatitur këtë rend dite.

Mirëpo, në ndërkohë, duke pasur ndihmën nga institucionet relevante që kanë një përvojë me disa prej çështjeve të cilat ne sot i kemi në rend dite, mbajtëm një mbledhje konsultative me shumicën e shefave të grupeve parlamentare dhe erdhëm në ujdi që ta lusim Kryetarin e Kuvendit që të na japë fjalën sot në shmangie të Rregullores së punës për ndërrim të rendit të ditës.

Në pajtueshmëri me AAK-në, PDK-në dhe me një a dy grupe të tjera parlamentare, ne lusim këtë seancë plenare që ta respektojë marrëveshjen që deri në konstituimin e Kuvendit, pas zgjedhjeve, në seanca plenare të kemi çështje për të cilat kemi një pajtueshmëri të plotë.

Njëkohësisht, kjo do të thotë çështjet e pyetjeve parlamentare, të cilat - në kohë të fushatës, qoftë si pyetje apo përgjigje – mund të kenë nuanca të fushatës, gjatë kësaj kohe të mos jenë, dhe debatet, të cilat janë politike, të zhvillohen në fushatë e jo në Kuvend.

Kemi edhe një sugjerim dashamirës të OSBE-së dhe të institucioneve shumë të respektuara për të drejtat e njeriut që çështjen e zgjedhjes së Avokatit të Popullit ta marrim në konsiderim për rishqyrtim dhe sot të mos jetë në rend të ditës.

Andaj, zoti Kryetar, ju lutem që, me një votë formale, ta përligjini vendimin, të cilin e kemi marrë në marrëveshje të plotë me shefat e grupeve parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Urdhëroni, Ramadan. E ka fjalën Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI: I nderuari Kryetar, i nderuari Kryeministër, ministra të pranishëm, deputetë të nderuar,

Ne, pikërisht në fillim të kësaj seance, bëme një vlerësim çfarë është ai i OSBE-së se duhet të hiqet nga vendimmarrja emërimi i Avokatit të Popullit.

Shkresa nuk ka asgjë të vërtetë. Këtë nuk e them si kryetar i Grupit Parlamentar, por si anëtar i Komisionit. Ne, me ndërgjegjen dhe përgjegjësinë më të madhe, e kemi përfunduar procedurën dhe në shkresë asnjë argument nuk është dhënë mbi shkelje procedurale. Andaj, shtyrja edhe e sotme, është kundërligjore dhe në kundërshtim me tërë procedurën e punës së këtij Kuvendi. OSBE-a ka qenë e involvuar në këtë proces dhe dëshiron ta ketë fjalën përfundimtare për Kuvendin. Këtë të drejtë, nuk e ka! Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Së pari, mendoj se duhet të marrim vendim. Ju lutem, vetëm një minutë. Dua të them, të marrim vendim se a duhet Parlamenti i Kosovës të vazhdojë punën më tutje apo jo?

(Ndërhyrje)

Ju lutem! Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e vet, të mbajtur më 25 tetor 2007, ka diskutuar lidhur me aktivitetin e Kuvendit gjatë fushatës zgjedhore.

Dhe, duke pasur parasysh Rregullën 5.2 të Rregullores së Punës, sipas të cilës Kuvendi i pezullon punët nga dita e fillimit të fushatës zgjedhore, Kryesia vlerësoi se, për të zhvilluar aktivitetin ligjvënës gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, Kuvendi mund të vendosë që përkohësisht t'i shmanget Rregullës 5.2 të Rregullores së Punës.

Shmangia e përkohshme, është paraparë me Rregullën 61, sipas të cilës, Kuvendi me 2/3 e deputetëve të pranishëm, vendos për shmangie nga Rregullorja e Punës, që do të thotë se duhet pasur 41 vota për këtë.

Lidhur me këtë, ishte edhe propozimi i shefit të Grupit Parlamentar të LDK-ës në marrëveshje edhe me shefat e grupeve të tjera parlamentare.

Prandaj, së pari ne duhet të marrim vendim, a të vazhdojë punën Kuvendi apo jo?

Pra, dëgjuat propozimin.

E hedh në votim këtë propozim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Të pranishëm në sallë janë 80 deputetë.

Votojmë tash.

Me 53 vota “për” dhe 1 “kundër”, Kuvendi vendosi që të vazhdojë punën edhe gjatë fushatës parazgjedhore. Ju faleminderit!

Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Zoti Kryetar, zoti Kryeministër, të nderuar deputetë,

Për faktin se, vërtetë, puna e Parlamentit më tepër është një punë për çështje të ligjeve dhe, në rrethana të zakonshme, parlamenti - gjatë fushatës zgjedhore, do të duhej ta pushonte aktivitetin e tij. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka bërë një kërkesë që është e njohur edhe për Grupin e Unitetit, por materiali nuk na ka arritur në kutinë postare. Kjo kërkesë i është drejtuar Grupit të Unitetit që ata të na informojnë pas përfundimit të bisedimeve 120-ditëshe dhe ne e mirëkuptojmë dhe e presim një informacion më të plotë për këtë periudhë.

Dhe, në anën tjetër, ndoshta edhe për shkak të fushatës zgjedhore, që dikush mund ta shfrytëzojë këtë debat për fushatë elektorale, jemi dakord që çështjet që kanë të bëjnë me debatin dhe çështjet që nuk janë të ngutshme, të hiqen nga rendi i ditës.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Dëgjuat propozimin. Kush është për propozimin e zotit Jakup Krasniqi?

Ju lutem, debat nuk ka dhe do të votojmë.

Kush është për tërheqjen nga rendi i ditës të pikës 4?

Votojmë me elektronikë.

Votojmë tash.

Me 53 vota “për” dhe 4 vota “kundër”, hiqet nga rendi i ditës pika e katërt e rendit të ditës.

(Ndërrhyrje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Ju lutem, tash kemi pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

- Emërimi i Avokatit të Popullit.

Ndërkohë kemi marrë një shkresë.

(Ndërrhyrje)

E kemi një shkresë nga OSBE-a dhe nga Zyra Evropiane që pika e rendit të ditës lidhur me Avokatin e Popullit të hiqet nga rendi i ditës së sotme, përkatësisht të përsëritet procedura e panelit.

(Ndërrhyrje)

Kush është për heqje nga rendi i ditës të pikës 12?
Regjia, bëhuni gati.
Votojmë tash.
Me 46 vota “për” dhe 22 “kundër”, miratohet propozimi.

Urdhëroni Teuta! E ka fjalën Teuta Sahatqija, me shfrytëzim të kartelës së Nazim Jasharit.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit; zoti Kryetar që, më në fund, më erdhi radha të flas.

KRYETARI: Grupi Parlamentar ka të drejtë të flasë 2 minuta lidhur me këtë çështje.

TEUTA SAHATQIJA: Po, s’ka problem, por përse dy minuta? U bënë tri votime, e nuk po dihet për çfarë u votua, si u votua dhe çka u bë?

Sa i përket kërkesës së parë, që u bë në emër të grupeve parlamentare, Grupi ynë Parlamentar nuk është konsultuar. Prandaj, mendojmë, nëse duhet të hiqen pyetjet parlamentare dhe në qoftë se duhet të hiqen temat, të cilat mund të konsiderohen si tema për fushatë, ne nuk jemi kundër, por mendojmë se do të duhej një kohë për konsultim dhe pastaj të japim mendimin tonë. E pastaj, do të vlerësohet se cila është temë e nxehtë, cila është temë e ftohtë, cila është temë për fushatë, cila nuk është temë për fushatë. Do të thotë, të ekzistojë një ekip i cili i trajton apo definon këto tema.

Dhe, ta shfrytëzoj dyminutëshin! Sot, patëm rast ta shohim demokracinë në veprim, demokracinë e ndërprerjes dhe të pengesës së deputetit për të folur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe juve! Urdhëroni Gjylnaze.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit! I nderuari, zoti Kryetar, i nderuari zoti Kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë,
Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, dëshiroj të propozoj që në të ardhmen puna e Kuvendit të zhvillohet vetëm për ligjet e mbetura. Dhe, për hir të punës së Kuvendit, unë propozoj që kjo të hedhet në votim dhe le të dihet se, në kohën e mbetur, do të merremi vetëm me ligje. Faleminderit!

KRYETARI: Për këtë, edhe votuam. E ka fjalën Gjergj Dedaj.

GJERGJ DEDAJ: Kryetar, të përshëndes shumë! Edhe, për pak, desha të duartrokas që ma dhatë fjalën!
I nderuar zoti Kryeministër, ministra, kolegë deputetë,
Po ndihem shumë mirë që po i vjen fundi këtij Parlamenti sepse singërisht për pak deshëm të bëhemi sikur një emision që është në media “përrallë me tupan”.

Nëse ky Parlament, afër një vit, nuk mund ta zgjedhë një avokat të popullit, çfarë Parlamenti është ky.

Nëse ky Parlament, nuk mund të japë përgjigje në çështjet kruciale, të rëndësishme që janë në vazhdimësi, atëherë çfarë Parlamenti është ky.

Nëse radhiten në rend dite pika të caktuara, pastaj i njëjti Parlament i heq - pasi kanë marrë vendim grupet parlamentare dhe Kryesia e Kuvendit, çfarë Parlamenti është ky.

Veç desha t'ju them se jam shumë i lumtur që po i vjen fundi këtij Parlamenti dhe nëse do të zgjedhim prapë një parlament të tillë dhe përfaqësues të tillë, është më mirë që të mos kemi zgjedhje më 17 nëntor. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe juve! Zoti Nait Hasani, e ka fjalën.

NAIT HASANI: Kryetar, nuk është hera e parë që po bën shkelje. I nderuar Kryeministër, për mua është një vendim që e kemi valid e që e ka nënshkruar shefi i Grupit Parlamentar dhe një material, që është dashur ta kemi, "Traktatin e miqësisë" – ku e kemi, dhe bisedimet që po mbahen në Uashington, Vjenë e Bruksel, janë në kundërshtim me interesat e qytetarëve të Kosovës ndërsa, ky Kuvend, sot, merr vendim për shtyrje të këtyre vendimeve dhe për ta bërë mundësinë që Serbia të vjen në Kosovë.

Unë kërkoj që ky Kuvend, pa marrë parasysh çfarë mendoni, mund të qesheni dhe e keni kohën për të qeshur, por dijeni edhe unë do të qesh me juve më vonë.

Unë them se sot Kuvendi i Kosovës në rend dite ka çështjen e debatit. Kërkoj që të hyjë në rend dite ky debat dhe t'i lëmë llafet çfarë po i bëni ju. Kërkesë e imja është, sepse kemi nënshkrimin dhe vazhdojmë debatin. Nuk ka pika të nxehta. Pika më e nxehtë është "Traktati i miqësisë" që është mashtrimi dhe konfederata me Serbinë. Cilët qytetarë janë në gjendje ta pranojnë një konfederatë me Serbinë? A e din kush - çka kanë nënshkruar, dhe kush e ka nënshkruar këtë? A e kanë lexuar deputetët këtë? Pse nuk ua keni sjellë deputetëve këtë? Çfarë po mendoni? A jemi ne kah dalim të shëtisim dhe t'ua çojmë gishtat dhe t'ua bëjmë aminin?

"Traktati i miqësisë" të cilin ju e keni nënshkruar dhe e keni ofertuar si ofertë, është konfederatë me Serbinë. Askush nuk ka të drejtë të thotë dhe bëjë këtë. Sepse, çfarë lidhje të drejta kemi me të, çfarë lidhje ne kemi me Serbinë, kur kemi pasur ne lidhje me Serbinë historike, të thella, politike, etnike, kulturore, arsimore e tjera – e tjera.

Ky është mashtrimi i parë që ia bëni ju vetes dhe qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit! E ka fjalën Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Zoti Kryetar, të nderuar deputetë, Ky Kuvend disa herë ka debatuar për procesin politik, e ka thënë fjalën e vet dhe përfundimisht gati në tërësinë e tij është pajtuar me dokumentin përfundimtar të bisedimeve të Vjenës, të përgatitur nga Presidenti Ahtisari.

Të gjithë e dimë se cilat kanë qenë arsyet për zgjatjen e bisedimeve edhe për 120 ditë. Dhe, natyrisht, nuk ka qenë në fuqinë as të Parlamentit të Kosovës e as të popullit të Kosovës ta detyrojnë Këshillin e Sigurimit të sjellë rezolutë të re për Kosovën, ashtu siç nuk mund asnjë traktat politik ta pengojë vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Se, e ka bërë Grupi i Unitetit një ofertë të tillë, ofertë që vërtetë nuk është pranuar nga pala serbe, më tepër ka qenë një qëndrim politik i Grupit të Unitetit për të ofruar një vullnet të mirë që ofron Kosova, ofrojnë qytetarët e Kosovës, jo për hir të Serbisë por për hir të proceseve politike të Kosovës, për hir që t'i jepet Kosovës hapësirë jo për t'u marrë me të kaluarën por për të menduar për të ardhmen.

Unë atë traktat e shoh si një vullnet të mirë të Grupit të Unitetit për t'u shërbyer proceseve që janë në vazhdim dhe jo historisë. Ne nuk kemi ardhur këtu për t'u marrë me historinë. Me historinë merret shkenca e historisë. Ne kemi ardhur këtu që të përpiqemi ta krijojmë një realitet të ri në Kosovë, Kosovën ta bëjmë shtet të pavarur dhe sovran dhe që e kërkon dhe e meriton mbështetjen ndërkombëtare. Ne jemi të bindur se Kosova e meriton pavarësinë, por këtë pavarësi duhet ta njohin edhe mekanizmat ndërkombëtar.

Prandaj, ne nuk e hoqëm nga rendi i ditës këtë kërkesë veç se ne nuk duam të debatojmë për të ardhmen e vendit tonë, e kjo është e drejtë e jonë dhe këtë të drejtë s'mund të na e merr askush, por konsiderojmë se kemi obligim të përgatitemi dhe kemi obligim ta presim informacionin e plotë që Grupi i Unitetit, që ka marrë besimin nga ky Parlament, të na japë informacionin e plotë për zhvillimin e bisedimeve gjatë këtyre 120 ditëve.

Duke pasur raportin e Grupit të Unitetit, ky Parlament, qoftë në këtë përbërje, qoftë në përbërje të re, e ka të drejtën dhe askush s'mund t'ia marrë atë të drejtë për të thënë fjalën e tij përfundimtare për procesin politik të Kosovës dhe në fund të fundit për ta mbrojtur vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, nuk kemi nevojë që në këtë kohë, kur ne duhet ta bëjmë fushatën dhe do ta bëjmë për veti secili me fshatarët dhe me zgjedhësit tanë, nuk është mirë që ta shfrytëzojmë Parlamentin për të dëmtuar një proces politik që, kam bindjen, duhet të jetë dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Ky Parlament do të vendosë edhe për Kushtetutën, edhe për procesin politik. Prandaj, nuk kemi pse t'i frikësohemi një dokumenti që ka ofruar Grupi i Unitetit edhe pse mund të mos kemi, në tërësinë e tij, vullnetin tonë më të mirë, por është një ofertë serioze për t'i hapur, edhe një herë e them – perspektivë të ardhmes së Kosovës.

Prandaj, edhe një herë po them, të presim informacionin që do të na vjen nga ky Grup i Unitetit dhe atëherë do të kemi kohë të bëjmë debat më të gjerë dhe, sigurisht, edhe në interes të qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit! Votimi është kryer për këtë.
Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

(Reagime)

Lidhur me pikën e rendit të ditës, është votuar.
Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbalit të seancës së 18 tetorit 2007.

A ka vërejtje në procesverbalin e seancës së 18 tetorit 2007?

Urdhëroni! E ka fjalën zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë kam vlerësim pozitiv për mënyrën si po përgatitet procesverbali, edhe për punën e administratës.

Megjithëkëtë, mendoj se do të ishte mirë të përfshihen edhe pyetjet që s'kanë marrë përgjigje.

Pyetja ime, drejtuar Qeverisë dhe, nëpërmjet saj Kryeministrit, më saktë - Grupit të Unitetit për Traktatin problematik si propozim të Qeverisë "për miqësi me Serbinë" në këto kushte, që e kam bërë edhe në emër të Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe pyetjet e tjera që janë brenda saj, meritojnë përgjigje, prandaj do të duhej të ishin përfshirë në procesverbal dhe shfrytëzoj rastin të them se edhe përkundër faktit pse jemi në fushatë, ndoshta pikërisht pse jemi në fushatë, e fushata mund të krijojë mjegullnajë për të bërë lojëra me Kosovën, duhet të merren seriozisht shqetësimet e qytetarëve dhe të deputetëve që të mos ngulfatet zëri i qytetarëve dhe as i deputetëve që kërkojnë transparencë e qartësi çka po ndodh me Kosovën në këto momente. Ka arsye plotësuese tash për ta shtruar këtë çështje 14 pikash. Propozimet e reja, këto s'mund të shkojnë siç kanë shkuar deri tani, sikur: "ia përmendim Kuvendit" dhe pastaj themi – "e ka miratuar Kuvendi". Kuvendi nuk e ka miratuar dokumentin e Ahtisarit në tërësi. E ka kritikuar dhe e ka kontestuar seriozisht pjesën më të madhe të tij, prandaj kjo duhet të merret parasysh dhe të mos lejojmë tash të krijohet përshtypja sikur edhe ky farë traktati ka bekimin e pashpallur të Kuvendit.

Ju lutem, zoti Kryetar, që pyetjet le të procedohen dhe le të futen në procesverbal. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Meqenëse nuk ka vërejtje në procesverbal, konstatoj se miratohet procesverbali nga seanca e 18 tetorit 2007, me sugjerimet e dhëna.

Urdhëro Fetah!

FETAH BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë kam një propozim. Meqë u mor qëndrim këtu se ky Parlament duhet të vazhdojë punën deri në formimin e Parlamentit tjetër e meqë jemi në fushatën elektorale, a është e mundshme që Parlamenti t'i mbajë seancat e veta më vonë, pas orës pesë, pas dite?

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Do ta shqyrtojmë këtë mundësi. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Koha për pyetje parlamentare.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Mund ta marrësh fjalën vetëm për këtë pikë, pika tjetër u krye. Xhevat, është kryer procedura për pikën e mëparshme!
Urdhëro, nëse ke pyetje?

XHEVAT BISLIMI: Të nderuar qytetarë të Kosovës, se këtyre më s'iu them as kryetar, as kryesi, se u pa çka është puna e tyre, e pa bile edhe populli shqiptar i Kosovës.

Ju, zoti Kryetar, sot shkelët procedurat me të dy këmbët. Ju shkelët vendimin që e keni marrë bashkërisht si Kryesi e si Kryetar. Ju, Grupi Negociator, keni bërë puç institucional dhe sot e keni shndërruar, dhe jo vetëm sot, këtë Kuvend në teatër kukullash. Dhe, po i përdorni, tamam si kukulla këta njerëz, e jo si deputetë që përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve dhe të popullit të Kosovës.

Prandaj, ky Kuvend, kishte një fillim....

(Vazhdon diskutimin, por nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Lus regjinë, le t'ia ndërpres fjalën.

(Ndërprerje nga regjia)

Ju lutem, do ta bëjmë një pauzë prej 15 minutash. Ftoj shefat e grupeve parlamentare që të vijnë për konsultime në zyrën time .

(Vazhdimi i punës pas pauzës për konsultime)

KRYETARI: Ju lutem, i zini vendet në mënyrë që të fillojmë me punë.
Ishte propozimi i shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, që të hiqet nga rendi i ditës pika: - Koha për pyetje parlamentare.

E hedh në votim.

Po e përsëris, ishte propozimi i shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, që të hiqet nga rendi i ditës pika: - Koha për pyetje parlamentare.

Votojmë tash, me elektronikë.

Me 39 vota “për” dhe 8 “kundër”, hiqet nga rendi i ditës pika: - Koha për pyetje parlamentare.

Pika e pestë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetimin parlamentar

Ky Projektligj është hartuar nga Komisioni Parlamentar për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 10 tetor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimi e tij, në parim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Legjislativ, zotin Hydajet Hyseni që ta marrë fjalën. Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Zoti Kryetar,

Zonja e zotërinj deputetë,

Është e vërtetë që me këtë mënyrë të menaxhimit dhe të hapjes së Kuvendit, jo vetëm që jam vënë në njëfarë konfuzioni unë, po druaj se është vënë i tërë Kuvendit. Nuk e kemi borxh dhe nuk do të duhej të krijojmë situata të tilla në këtë fazë.

Më lejoni, zonja e zotërinj deputetë, që në emër të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion e Kornizë Kushtetuese, t’i prezantoj këtij Kuvendi në një kohë jo fort të përshtatshme, Projektligjin për hetimin parlamentar, projektligj i cili është iniciuar në përputhje me rregullat e procedurës të Kuvendit të Kosovës, në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Nr. 02-406, datë 9 maj 2005, që ka miratuar kërkesën e Komisionit për Legjislacion dhe Çështje Kushtetuese për t’i hyrë përgatitjes së këtij ligji, i cili i është nevojitur Kosovës.

Grupi Punues në përbërje, fillimisht dhe gjatë procesit: Hydajet Hyseni, Kolë Berisha, Shpresa Murati, Iljaz Ramajli, prof. dr. Ismet Salihu, prof. dr. Rexhep Gashi, këta janë nga jeta akademike, si dhe Mazllum Baraliu, nga Shoqata e Juristëve të Kosovës dhe ekspertët e Agjencionit Evropian për Rindërtim Virtyt Ibrahimaga, dhe Jarn Dirk Bllaauw si dhe ekspertët Guido Oestreich dhe Peter Van Haut, kanë punuar një kohë të gjatë dhe kanë sintetizuar përvojat më të mira të vendeve përreth nesh dhe të atyre me përvojë të rëndësishme në fushën e hetimit parlamentar.

Edhe Kosova ka pasur një përvojë modeste. Kanë funksionuar dy komisione parlamentare. Njëri për arsyet që i dini, përveç tjerash edhe për shkak të mungesës së bazës ligjore, ka qenë i penguar ta përfundojë misionin për të cilin ishte themeluar, kurse ky i dyti, megjithatë ka arritur të bëjë një punë dhe përvoja e të dyjave këtyre ka qenë e mirëseardhur në hartimin e Projektligjit për hetimin parlamentar.

Ky është një Projektligj i hartuar nga vetë Kuvendi i Kosovës, që rregullon një instrument shumë të rëndësishëm demokratik të funksionimit të Kuvendit të Kosovës, dhe është një instrument shumë i rëndësishëm edhe i funksionimit demokratik dhe i

kontrollit demokratik edhe ndaj ekzekutivit dhe institucioneve të tjera në Kosovë. Si i tillë konsiderojmë se edhe do të duhej të shqyrtohej në një procedurë të veçantë. Projektligji ka qenë shtruar edhe në debate të gjera edhe në rrethe të ndryshme në Kuvendin e Kosovës. Kemi shfrytëzuar edhe sugjerimet, vërejtjet që na janë dhënë nga partnerët e ndryshëm brenda e jashtë, janë organizuar edhe tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të grupeve parlamentareve, të komisioneve dhe janë sintetizuar edhe vërejtjet e tyre, kështu që besoj se, si i tillë, ky projektligj do ta ketë më të lehtë fazën e mëtejshme të shqyrtimit.

Meqë jemi në fund, unë nuk do ta përjashtoja edhe mundësinë, te ne ende të pa aplikuar, që shqyrtimi i parë dhe shqyrtimi i dytë, të bëhen në të njëjtën kohë. Por, meqë ne sot vendosëm që të vazhdojmë me miratimin e ligjeve edhe në të ardhmen, atëherë ajo që do të kërkonim është që, meqë deputetët e kanë pasur në dorë dhe kanë qenë pjesë e hartimit të këtij Projektligji dhe të finalizimit të tij, procesi i shqyrtimit të dytë të përshpejtohet.

Zoti Kryetar,

Ne si Komision kemi sugjeruar që mundësisht shqyrtimi i dytë pas miratimit në parim, që besojmë është i pakontestueshëm edhe sot, të mos vonohet e zvarritet më shumë, por të vihet në procedurë që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

Unë dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Grupit Punues, veçanërisht ekspertët për ndihmën që na kanë dhënë, dhe besoj që me këtë ligj ne po i sigurojmë legjislaturës së ardhshme një bazë solide për funksionalizimin e një instrumenti shumë të rëndësishëm demokratik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Sadudin Berisha, në emër të LDK-së.

SADUDIN BERISHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës me kujdes dhe përgjegjësi ka shqyrtuar Projektligjin për hetim parlamentar. Vlerësimi është se ky projektligj është i nevojshëm për Kosovën dhe për Kuvendin e Kosovës, meqë kjo fushë nuk ka qenë deri më sot e mbuluar dhe si nevojë e paraqitur herë pas herë.

Ky Projektligj ka bazën juridike kushtetuese dhe qëllimi i këtij Projektligji është të mbulojë një fushë të një rëndësie të veçantë që ka të bëjë me hetimin parlamentar. Ky Projektligj rregullon procedurat që nga themelimi, kompetencat, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit Hetimor Parlamentar. Është një Projektligj me gjithsej 25 nene dhe 6 kapituj.

Në emër të Grupit Parlamentar e mbështesim këtë projektligj, si projektligj të rëndësishëm së veçantë dhe në parim e përkrahim, me mundësinë që në leximin e dytë ta japim kontributin tonë për amendamentimin e tij. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të AAK-së, Gjylnaze Sylaj.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për hetimin parlamentar është një kontribut i rëndësishëm për kompletimin e Kornizës ligjore për punën e Kuvendit të Kosovës. Për më shumë, ky Projektligj, ashtu siç është propozuar, është një hap i mëtejshëm që shkon në drejtim të përafrimit të praktikave të mira parlamentare si të vendeve me demokraci të avancuara.

Ne në këtë mandat kemi pasur një përvojë me Komisionin Hetimor, i cili ka pasur vështirësi në organizimin e punës së vet, duke marrë parasysh se nuk ka pasur një bazë ligjore për vetë funksionimin dhe formimin e atij komisioni. Prandaj, është e rëndësishme që ky projektligj të kalohet sot dhe të aprovohet.

Projektligji është mjaft komplet dhe përfshin procedurat, duke filluar nga formimi i Komisionit Hetimor, misioni që e ka deri te sjellja e raportit të komisionit para Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, është mjaft preciz në përshkrimin e detyrave të Komisionit dhe të detyrave të organeve të tjera Kuvendit lidhur me funksionimin e këtij komisioni. Kjo do të thotë se Komisioni Hetimor Parlamentar, të dhënat të cilat i mbledh, i mbledh për rastet e caktuara nga resurset e ndryshme dhe nuk bazohet në të dhënat që vijnë nga pushtet e tjera, siç janë ato të gjyqësisë ose të Qeverisë.

Parimi themelor në këtë Projektligj, që është shtyllë e komisionit, është e drejta e minoritetit politik të ngrisë komisionin, do të thotë që grupet e vogla parlamentare mund të ngrisin komisionin. Nga ana tjetër, gjithashtu është vërtetuar se duhet dhe qëndron vërtet në Projektligj, se duhet të reflektojë fuqitë e përfaqësuara në Kuvend, që është parimore në praktikën dhe doktrinën parlamentare, që do të thotë se mazhoranca e ka vetëm një anëtar më shumë në Komision, dhe kjo ofron një zgjidhje të balancuar politikisht.

Në këtë projektligj, në disa dispozita përcaktohet parimi i ndarjes së pushteteve, gjë që është për t'u përshëndetur. Pra, Kuvendi nuk guxon të jetë një vend ku vendoset për përgjegjësinë penale të personave. Hetimi parlamentar fokusohet në zbardhjen e rasteve, aty edhe duhet të zbardhet përgjegjësia politike e personave, por jo edhe ajo penale.

Qasje në raportin të cilin e bën Komisioni, do të kenë edhe organet e tjera publike. Projektligji gjithashtu përmend dispozitat e Kodit të procedurës penale, që janë të aplikueshme në mënyrë analoge në procedurat e thirrjes së dëshmitarëve dhe të marrjes në pyetje të dëshmitarëve. Do të thotë, me Projektligj është përcaktuar dhe është siguruar që, njerëzit të cilët do të ftohen të bëjnë dëshmi, duhet të vijnë, përndryshe do të kenë konsekuencë juridike. Pra, është mirë që personat e tillë, e një gjë e tillë vlen edhe për organet ekzekutive duhet të bashkëpunojnë, sepse nuk mund të imagjinohet një punë efektive e Komisionit Hetimor, nëse komisioni nuk ka mekanizma për t'i detyruar personat ose organet që t'i paraqesin dokumentet ose dëshmitë për rastin.

Së fundi, duhet të përsëritet fakti që në këtë Projektligj janë futur, pra, mekanizmat detyrues për bashkëpunim me Komisionin. Sa i përket kostos buxhetore, i cili është paraparë 56,880 € në muaj, mendoj që Buxheti i Kosovës mund ta përballojë.

Për shkak të arsyeve të cilat i përmenda, Grupi parlamentar i Aleancës në parim e përkrah Projektligjin dhe fton deputetët që ta mbështesin këtë iniciativë të mirë të Komisionit Legjislativ. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të ORA-s, deputeti Gazmend Muhaxheri..

GAZMEND MUHAXHERI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në emër të Partisë Reformiste ORA përkrahim këtë projektligj dhe besojmë se në leximin e dytë do të përmirësohen ato pika që kanë mbetur si dilema dhe shpresojmë që ky Kuvend do ta aprovojë këtë ligj sa më parë. Ju Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Sayın Meclis Başkanı değerli milletvekilli arkadaşlarım Altı + parlamentar grubu bu kanunu prensipte destekliyorum bugün isterdi ki daha uygun bir zamanda gelsini ama ona rağmen bu çalışmalar neticesinde bizde grup olarak birinci okunuşunu destekliyoruz ikinci okunuş sırasında da ve ondan önceki süreçte komisyonlar tarafından gerekli düzeltmeler yapılacağına inanıyoruz. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDD-së, Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI: I nderuari Kryetar,

I nderuar ministër prezentë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar këtë propozim ligji dhe në veçanti përgëzon kryetarin e këtij grupi dhe Grupin hartues për një punë të çmuar dhe me vlerë për punën e mëtutjeshme.

Ne mendojmë se Ligji për hetime parlamentare, do të duhej të emërtohej: Ligji për hetime dhe procedura hetimore parlamentare, për ta plotësuar përmbajtjen të cilën dëshiron ta rregullojë. Po ashtu, hetimi parlamentar duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë edhe me ligjet ekzistuese, përndryshe në disa dispozita do të kemi shkeljen e parimit të ligjshmërisë dhe mos pajtueshmëri të këtij propozim ligji me ligjet pozitive.

Komisioni themelohet për qëllim të informimit. Mendoj se kjo duhet ndryshuar dhe të thuhet: “për të vërtetuar dhe argumentuar ngritjen e çështjes e cila është ngritur në procesin hetimor”, e jo vetëm për të informuar, sepse po që se mbetet kështu, për të bërë informimin, atëherë informohet nga iniciatori i çështjes dhe me atë përfundon. Qëllimi i procedurave hetimore apo i këtij ligji, duhet të përfundojë. Nëse nuk përcaktohen drejt, do të lindin probleme dhe këtu është fushëveprimi i Komisionit.

Në fushëveprimin e Komisionit unë do t'i paraqes disa amendamente për ta përcaktuar dhe saktësuar. Mendoj se Komisioni Hetimor nuk duhet të ketë mandat të gjatë, por

vetëm për çdo rast, dhe me rastin e përfundimit të hetimit, duhet formuar komision të ri. Kjo do të ishte ajo që i jep vlerën Komisionit Hetimor. Një komision hetimor e pushon punën pasi që të ketë hetuar çështjen dhe i paraqet vendim, gjegjësisht propozim konkret Kuvendit dhe Kuvendi është organi më i lartë i cili merr vendim lidhur me çështjen hetimore.

Ky Propozim ligj patjetër duhet të saktësojë që Komisioni Hetimor duhet të përcaktohet se, nëse ka filluar procedura gjyqësore hetimore, a ka të drejtë dhe a vjen në kolizion me procedurën e mëtutjeshme dhe a duhet zhvilluar dy procedura paralele për një çështje të njëjtë. Mendoj se Komisioni Hetimor do të ishte mirë të ketë përbërje edhe profesionale, e jo vetëm atë të grupeve parlamentare, sepse në shumë çështje, që ngriten kalojnë edhe suazat e karakterit kuvendor. Anëtarët që largohen apo nuk dëshirojnë të punojnë në Komisionin Hetimor, duhet të japin arsyetimin me shkrim përse largohen, sepse edhe këtu mund të vijë në shprehje konflikti i interesave dhe pamundësia e funksionimit të Komisionit.

Komisioni Hetimor nuk duhet të marrë vendime paraprake, por vetëm propozime, të cilat do t'i miratojë Kuvendi. Ky propozim nuk paraqet masat ndaj personave apo anëtarëve të Komisionit, të cilët nuk i përgjigjen thirrjes, eventualisht edhe ndaj deputetit për të cilin është ngritur hetuesia.

Duke përfunduar, më lejoni që edhe një herë ta konfirmoj përkrahjen tonë, në parim, dhe ne do të paraqesim disa amendamente me të cilat do ta begatojmë, përkundër faktit që ky propozim ligji i plotëson kriteret në procedurën e mëtutjeshme. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Grupi për Integrim, Gjergj Dedaj.

GJERGJ DEDAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar për Integrim i jep në parim mbështetje këtij Projektligji për hetim parlamentar, me shpresë se komisioni adekuat, por ndoshta edhe në konsultim edhe me profesionistë të fushës së caktuar, do ta begatojë, do t'i marrë sugjerimet dhe do ta plotësojë, në mënyrë që në leximin e dytë të kemi një ligj të qëndrueshëm, sepse është tejet i rëndësishëm për të ardhmen e zhvillimit demokratik të Kuvendit të Kosovës dhe të shoqërisë kosovare në përgjithësi. Ju faleminderit shumë!.

KRYETARI: Ju faleminderit! Meqë nuk ka të interesuar të tjerë për diskutim, e hedh në votim miratimin, në parim, të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten. Në sallë janë 65 deputetë.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për hetimet parlamentare.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, si komision funksional dhe raportues, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për

Komunitete, duhet brenda dy muajve ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin rekomandime dhe propozimin për miratim.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Vazhdojmë seancën me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 27 gusht 2007. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet, si vijon:

1. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin për rrugët ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.
2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Në vazhdim, do të procedojmë me shqyrtimin e amendamenteve një nga një, sipas radhës.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” në mënyrë elektronike dhe 2 vota me ngritje dore, pra 56, dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe 2 “kundër”, pra duke llogaritur gjithnjë 2 votat me dorë që nuk kanë kartelë, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti nr. 6

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” – po llogaris 2 vota me dorë, ju lutem, dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti nr. 7

Votojmë tash:

I kemi 4 vota tani me dorë, katër deputetë.

Me 58 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti nr. 8

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Me 43 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Me 46 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Me 48 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë tash:

Me 49 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë tash:

Me 51 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë tash:

Me 51 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe 1 “kundër”, duke llogaritur 4 vota me dorë, miratohet amendamenti 31. Prezenca në votim ishte 67 deputetë.

Lus deputetët që të deklarohen për tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e votuara një nga një. Qes në votim Projektligjin në fjalë.

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, duke llogaritur 4 vota me dorë, dhe asnjë “kundër”, miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Konstatimet hyrëse. Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 14 shtator 2007. Komisionet Parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet, si vijon:

1. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.
2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe amendamentet e propozuara përmbajnë implikime buxhetore si dhe ka propozuar një amendamentet.

Në vazhdim, lus deputetët që të përgatitjen për votimin e amendamenteve.
Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri. E keni fjalën.

TEUTA HADRI: Unë kisha dashur vetëm t'ua bëjë më të qartë deputetëve propozimin që ta pranojnë amendamentin e zoti Ramadan Kelmendi, sepse është një amendament që e kemi analizuar mirë, Nëse ne e pranojmë këtë si është në Projektligj, ne do ta dëmtojmë një kategori të njohësve apo të ekspertëve të ardhshëm që çdo parti do ta ketë në të ardhmen problem, sepse nuk është menduar për personelin e shëndetësisë, kategorinë e shëndetësisë, se nëse mjekët e ardhshëm që mendoni t'i keni deputetë të parlamentit të ardhshëm, dhe ju propozoni këtë ligj qysh është dhënë, atëherë ata do të ikën dhe nuk do të vinë si ekspertë dhe në radhët e juaja do të mungojnë këta njerëz për shkak se ky amendament e dëmton punën e tyre katërvjeçare nëse bëhen deputetë. Prandaj, propozoj, të mos e zgjas, që zoti Kelmendi ka plotësisht të drejtë dhe ta përkrahni këtë.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Deputeti Ramadan Kelmendi e ka fjalën.

RAMADAN KELMENDI: Ju Faleminderit!

Unë, duke ju përshëndetur, edhe njëherë falënderoj hartuesin, por si deputet, duke shfrytëzuar të drejtën time, kam paraqitur disa amendamente. Për të mos qenë i mërzitshëm me secilin amendament, unë mendoj se amendamentet e mia të paraqitura kanë pasur, kanë dhe duhet të kenë mbështetje të arsyeshme të bazuar juridike me këtë qëllim:

1) Qëllimi i amendamenteve është që t'i mundësohet çdo deputeti ta ushtrojë profesionin e tij si dhe të mos diskriminohet mbi bazën profesionale. Çështja e rregullimit të çështjeve të amendamentuara nga unë rregullohet me ligje të tjera, me Ligjin mbi shërbimin civil, me rregulloret dhe urdhëresat e kësaj kategorie.

2) Me Ligjin themelor të punës, me Kontratën kolektive, e cila nuk zbatohet, dhe me Ligjin mbi konfliktet e interesit, bazuar në këtë, unë ju propozoj që vërtet t'i aprovoni amendamentet e mia dhe, në veçanti, të gjitha këto që i thashë më lartë i përkufizon në mënyrën më të mirë juridike dispozita e plotësuar, neni 5, pika 3, ku thuhet se deputeti i cili ushtron marrëdhënie pune të rregullt në sektorin publik, sepse në atë privat as që kemi të drejtë të hymë, dhe ky ligj ndërhyjnë dhe shkel të drejtat shumë individuale dhe personale të punës private, obligohet të deklarojë me shkrim, pra obligohet të deklarojë me shkrim pagën primare, ashtu siç e kam deklaruar unë gjashtë mandate, dhe e saktëson me shkrim pagën primare brenda 15 ditësh, nëse kjo mbulon të gjithë arsyeshmërinë e ligjeve të mëparshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI Të nderuar deputetë, ju lutem, ia dhashë fjalën deputetit Ramadan Kelmendi dhe ky dha arsyetimet për të gjitha amendamentet që i ka propozuar në mënyrë që të mos e merr fjalën për çdo amendament veç e veç.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Më lejoni edhe në cilësinë e kryesuesit të Komisionit të bëjë një sqarim. Respekt për deputetin Kelmendi, dua të lavdëroj punën e tij edhe në Komision, edhe në këtë Ligj. Por, amendamenti që e keni në vijim nga Komisioni, amendamenti 2, është në të vërtetë një përmirësim i tekstit fillestar që bën përpjekje për të gjetur një zgjidhje midis angazhimit të drejtë edhe të zotit Kelmendi, edhe të disa deputetëve kur është çështja të inkompatibiliteti dhe propozimit fillestar që është vlerësuar se mund të jetë tepër përjashtues. Më lejoni vetëm një sqarim. Arsyeja pse kemi punuar në këtë ligj ka qenë një nga motivet që deputetët të fokusohen më shumë në punën e Kuvendit se sa në punët dytësore. Mendoj, se duhet ta kem parasysh, por pa lejuar teprime. Prandaj, ne kemi propozuar një zgjidhje kompromisi që, në parim, deputeti ta ketë punën e deputetit parësor, por në raste kur konsiderohet se është i rëndësishëm interesi shoqëror, është deficitar, t'i lihet Kryesisë kjo mundësi që t'u lejojë deputetëve edhe punët dytësore. Prandaj, mendojmë që propozimi që kemi propozuar ne si Komision nuk e përjashton shqetësimin e zotit Kelmendi edhe në disa amendamente të mëvonshme. Unë, megjithatë, mendoj që kësaj radhe duhet të votohet amendamenti i Komisionit, sepse është fleksibil, është pajtues. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Replikë ka Ramadan Kelmendi, e keni pasur fjalën, keni replikë. Më nuk e merrni fjalën për asnjë amendament.

RAMADAN KELMENDI: Kërkoj falje, vetëm edhe dy amendamente t'i arsyetoj në pika të shkurtra, se harrova. Ju lutem, është me rëndësi. Replikë është, kam të drejtë. Ju lutem, amendamenti 24 duhet të plotësohet me amendamentin 24.4. Arsyetimi është shumë i thjeshtë dhe burimor. Pensioni bazë suplementar çdo të punësuar për punën e kaluar i njihet 2%. Unë kam propozuar edhe me shumë të drejtë, deputeti të cilit i njihet statusi i burgosurit politik, koha e kaluar në burg i llogaritet si stazh pensional në lartësi prej 2% për çdo vit. Është shumë e drejtë dhe nuk dua ta keqpërdori këtë foltore për t'i mbrojtur të burgosurit politik të cilët kanë qenë deputetë në mandate. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zylfije Hundozi e ka fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Unë shkurtimisht desha vetëm ta shpjegoj dhe ta sqaroj pak kërkesën e doktoreshës Teuta Hadri. Mjekët nëse nuk punojnë në profesionin e vet, le të jetë ajo edhe 4 orë, do ta humbin të drejtën për ta marrë licencën. Do me thënë, kusht i domosdoshëm për t'u licencuar një mjek është të ketë një kontinuitet në punën e vet. Le të jetë ajo që ka propozuar Ramadan Kelmendi gjysma e rrogës, gjysma e orarit të punës, diçka simbolike, vetëm të jetë në kontinuitet. Prandaj, i lus deputetët e këtij Kuvendi që t'i përkrahin amendamentet e Ramadan Kelmendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Unë do të flas për të gjitha amendamentet përnjëherë dhe nuk e marrë më fjalën.

(Ndërhyrje e kryesuesit): Jo, jo, të lutem, nuk ka nevojë me na sqarua, të lutem, voto ose mos voto, të lutem.

GJYLNAZE SYLA: Në qoftë se këto hiqen, atëherë hiqet shtylla e Projektligjit. Kam të drejtë, zoti kryesues, se kam punuar vetë në këtë Projektligj. Argumenti është se punësimet tjera japin mundësi të ketë konflikt interesi. Nëse në të dyja do të jetë në pushtet, edhe në legjislativ, edhe në ekzekutiv, atëherë jep mundësinë për të ndikuar në favor të vetin. Mendoj se kjo është esenciale për Kuvendin dhe me këtë Ligj Kuvendi vendos se a do të jetë Kuvend i plotë ose jo i plotë. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit!
Deputetja Nerxhivane Dauti e ka fjalën, si eksperte. Urdhëroni!

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve dhe lidhur me këtë Projektligj kaq të rëndësishëm dëshiroj të jepi disa sqarime në cilësinë e udhëheqëses së Grupit punues për përpilimin e ligjit në fjalë.

Zoti Kryesues,

Problemi qenësor ka qenë te neni 5 i Projektligjit mu për këto të cilat i theksoi zonja Teuta Hadri, doktoreshë, dhe doktoresha tjetër. Problemi është për çështje e ekspertëve të lëmive të ndryshëm, për profesorët e fakultetit, për ekspertë të ndryshëm të lëmive të ndryshme. Kemi pasur një debat shumë të gjerë lidhur me këtë çështje, ka pas propozime të ndryshme, ndër më të ndryshmet, janë bërë variante të ndryshme të Projektligjit në fjalë dhe këtu i kemi të radhitura dy amendamente: amendamenti 1 dhe amendamenti 2. Amendamenti 1 të cilën e ka paraqitur zoti Kelmendi ma merr mendja se është një amendament shumë i arsyeshëm sepse rregullohet edhe me çështje të ligjeve tjera sistimore që janë duke u aplikuar në Kosovë. Ligji për shërbimin civil, të cilin e përmendi zoti Kelmendi, ka garantuar prezantimin e pagës primare dhe sekondare dhe kjo është një zgjidhje shumë e drejtë, shumë e mirë, që do të thotë se ne jemi të kënaqur si ekspertë. Edhe me shifat e grupeve parlamentar mendoj se kemi arritur një harmonizim, dhe me ekspertë të cilët i kemi këtu në Kuvend, por të fushave të ndryshme. Unë thërras Kuvendin, apeloj që çështja e ngritur nga zoti Kelmendi është jo një ambicie, por është një zgjidhje shumë e drejtë. Prandaj, ai i cili dëshiron të bëhet deputet, e ka përpara pasqyrën. Nëse do që të bëhet me pagën primare, e zgjedh Kuvendin, nëse nuk do, e zgjedh pagën tjetër. Prandaj, kjo është një zgjidhje shumë e mirë në qoftë se doni ekspertë.

Prandaj, është një çështje shumë e vlefshme për t'u diskutuar. Më falni për minutat të cilat ua kam marrë, por është një zgjidhje shumë e mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit shumë, zonja deputete! Ju lutem, për fjalë është paraqitur deputeti Ramadan Musliu dhe besoj që u shterua arsyeja e debatit të mëtejme.

RAMADAN MUSLIU: I nderuari kryesues,
Të nderur kolegë deputetë,

Brenda të njëjtës seancë na i kemi për lexim të dytë dy projektligje. Është ky ligj dhe Ligji për konfliktin e interesave. Aprovimi i këtij amendamenti i propozuar nga Ramadan Kelmendi mendoj se nuk e lejon aprovimin e Projektligjit për konfliktin e interesit për shkak se ndikon në ndryshime rrënjësore. Secili që e ka lexuar seriozisht Projektligjin për konfliktin e interesit e sheh se duhet të bëhen ndryshime thelbësore në atë Projektligj, do me thënë ne nuk guxojmë ta aprovojmë. Me qenë se nuk është kryetarja Nekibe Kelmendi këtu, atëherë po detyrohem si anëtar i këtij Komisioni ta bëjë këtë intervenim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet amendamentin numër 1 të propozuar dhe do të votojë për të dhe e mbështet edhe amendamentin 3, ndërsa nuk e mbështet amendamentin 4 edhe më vonë do të vijmë me radhë. Ju lutem ta hidhni në votë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fatmire Mulhaxha Kollçaku. Urdhëroni, ju lutem deputete!

FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Faleminderit, zoti Kryesues!

Vetëm një sugjerim për seancë. Duke pasur parasysh që ne s’kemi sistem pensional, s’kemi sigurim pensional, nuk është nxjerr Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, u sugjeroj të gjithëve të kenë parasysh që para se të miratohet Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, ky Ligj nuk mund të shkoj përpara atij Ligji, sepse i rregullon çështjet që duhen të rregullohen me një ligj tjetër. Nuk mund t’i garantojmë vetes diçka që nuk u është garantuar qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Amendamenti 1

Pra, amendamenti numër 1 deputeti Ramadan Kelmendi, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Votojmë tash:

Lus deputetët që votojnë me dorë, nëse janë “për”, të ngritin dorën.

4 vota “për”. Me 39 vota “për” dhe 21 “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Unë thashë, ju lutem. I lus deputetët që votojnë me dorë, kur të them kush është “për” nga këta që votojnë me dorë, le të ngrisin dorën në mënyrë që unë t’i numëroj. Ishte edhe një votë “kundër”. Ju faleminderit, zoti Nazim Jashari, por nuk ka ndikuar në rezultat përfundimtar. Ju faleminderit!

Amendamenti 2

Komisioni funksional, votojmë tash:

Më fali, është i pa objekt amendamenti numër 2, nga juristët.

Kalojmë në amendamentin 3

Alush Gashi e ka fjalën, ju lutem.

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Amendamenti numër 3 lidhur me nenin 6.1 nëse shkon në këtë formë, atëherë neni 7 hiqet. Kërkojmë që të votohet, të hiqet në tërësi neni 6 edhe atëherë amendamenti 4 bëhet i pavlerë.

Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Zoti Kryesues,

Më lejoni që të bëj vërejtje së pari që amendamentet nuk janë radhitur mirë dhe kjo po shkakton konfuzion.

E dyta, për amendamentet sipas procedurës sonë lejohet një mendim kundër, një pro dhe votohet. Më lejoni të konstatoj së paku se deputetët i votuan të dy amendamentet dhe kjo do të hap një dilemë. I votuan sepse logjikisht amendamenti i propozuar nga Komisioni, do të thotë nga shumica, e përfshinte sugjerimin që t'u mundësohet deputetëve me arsye specifike për funksionet deficitare të rëndësishme që ta rregullojnë këtë me Kryesinë. Do të thotë ishte pajtues, prandaj edhe e mora fjalën.

Më lejoni të tërheq vërejtjen tash te amendamenti 3. Për mendimin tim duhet të sqarohet edhe një herë amendamenti i mëparshëm, por nuk ka qenë e rastit pse Grupi punues, Grupi hartues dhe ekspertët kanë sugjeruar që në përvojën tonë të mos lejojmë bashkëdyzimin e funksioneve të deputetit me atë të zëvendëskryeministrit, të ministrave, të zëvendësministrave. Mua më kanë thënë vetë ata që janë ministra e zëvendësministra se s'po funksionon, nuk shkon, nuk ka shkuar. Pse po bëhen zgjidhje që nuk na funksionojnë, vetëm për hatër të dikujt, apo për inate. Prandaj, mendoj është mirë t'i rishikojmë dhe ta respektojmë parimin e inkompatibilitetit të funksionit të deputetit. Shikoni sa kemi deputetë sot, shikoni nëpër komisione sa ka, sepse shkojnë në punë tjera dhe puna e parlamentit mbetet në plan të dytë. Në Zvicër e diku tjetër edhe mund të funksionojë kjo, por në Kosovë s'duhet zotëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Shkojmë në votim.

Amendamenti 3

Deputeti Ramadan Kelmendi, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet e Financa.

Votojmë tash:

Me 32 vota "kundër" dhe 16 "për", nuk miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Deputeti Ramadan Kelmendi pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet e Financa.

Votojmë tash:

Ju lutem, përkrahja e Kuvendit, kuorumin e kërkoj, prezencën ju lutem.

Votimi për amendamentin numër 4 është i pavlefshëm, kuorum nuk ka, janë 57 deputetë. Shihemi të premten në orën 10,00.

Vazhdimi i Seancës plenare të 30.10.2007 më 2.11.2007 në orën 10:00.
Mbledhjen e drejtoi Kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha

KRYETARI: Mirë mëngjesi dhe mirë se keni ardhur!
Fillojmë me seancën plenare. Vazhdojmë ku kemi mbetur të martën.
Në sallë janë 62 deputetë, kështu që janë plotësuar kushtet që të fillojmë me punë.

Jemi te pika e 7-të e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Të martën janë votuar 3 amendamente, tani jemi te amendamenti 4.

Amendamenti 4

Deputeti Ramadan Kelmendi, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet e Financa.

Votojmë tash, bën të votohet edhe me ngritje dore.

Me 39 vota “për” dhe 13 “kundër”, miratohet amendamenti .

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 44 vota “për” dhe 13 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 6

Kemi dy propozime. Propozimi i deputetit Behxhet Brajshori, i përkrahur nga komisioni funksional dhe Komisioni për Buxhet e Financa dhe amendamenti i deputetit Ramadan Kelmendi, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet e Financa.

Urdhëroni! Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit zoti Kryetar,

Pa lejuar që të kthehemi në pjesën e miratuar, ashtu si u miratua, unë mbetem me vërejtjen që kam thënë në fillim. Por këtu ka nevojë të sqarohet se çështja e pjesëmarrjes në bordet është një çështje edhe më e ndjeshme, prandaj s’do të ishte mirë të shkohet sipas inercisë dhe rutinës si deri tani. Nuk ka logjikë që deputeti të jetë edhe pjesë e bordeve ku ka edhe konflikt interesash. Nëse nuk arritëm që pjesën e parë ta korrigjojmë sepse amendamenti i parë i miratuar nga Kuvendi e determinonte edhe këtë rrjedhë, këtu ka mundësi megjithatë që të bëhet një ndryshim dhe mendoj që është në të mirën edhe të ndarjes së pushteteve, sidomos në fushat shumë të ndjeshme. Kërkoj mirëkuptimin tuaj. Prandaj, propozoj që të miratohet amendamenti i zotit Brajshori.

KRYETARI: Shkojmë në votim për propozimin e deputetit Behxhet Brajshori.

Votojmë tash:

Me 53 vota me elektronikë dhe 4 me dorë, 57 vota “për” dhe 4 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 42 vota me elektronikë dhe 4 me dorë, 46 vota “për” dhe 17 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Secili ka mundësi ta marrë fjalën.

Urdhëroni, profesor Sabriu.

SABRI HAMITI: Asgjë nuk ka kaluar si duhet, vetëm është mënyra e komunikimit. Ju keni thënë secilën herë kalon amendamenti, e në të vërtetën nuk ka kaluar amendamenti. Në rregull është kjo, vetëm akceptimi është gabim. Ramadani që është jurist dhe i ka propozuar vetë, e di shumë mirë çka ka ndodhur. Faleminderit!

Amendamenti 8

Deputeti Ramadan Kelmendi, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet e Financa.

Votojmë tash:

Me 37 vota “për” dhe 26 “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar,

Tërheq vërejtjen e deputetëve se amendamenti i zotit Kelmendi bën disa korrigjime të bazuara të natyrës redaktuese, por e përjashton funksionin e kryetarit të nënkomisionit nga mundësia e kompensimit. Nënkomisionet kanë punë shpesh po aq sa komisionet, e ndonjëherë më shumë se ndonjë komision. Mendoj që duhet të përfshihet. Prandaj, me vërejtjet redaktuese të zotit Kelmendi, duke përfshirë edhe kryetarin e nënkomisionit, mendoj se mund të miratohet. Faleminderit.

KRYETARI: E hedhim në votim.

Votojmë tash:

Me 36 vota “për” dhe 20 “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: E shoh të arsyeshme që sqaroj Kuvendin për një vështirësi që është për shkak të radhitjes së amendamenteve. Është fjala për çështjen e ndjeshme të

pensioneve suplementare për deputetët. Grupi punues ka bërë këtë propozim të cilin e kemi diskutuar dhe është praktike e shumë parlamenteve. Megjithatë, ne nuk jemi të përgatitur për t'i realizuar të gjitha këto qysh parashihen në këtë pjesë të ligjit. Prandaj, unë kam propozuar një formulë kompromisi që është në amendamentin 13, por ky amendament do të duhej pasur parasysh që në fillim, sepse kërkon që të fshihet gjithë kapitulli, të gjitha nenet që e rregullojnë çështjen e pensionit suplementar dhe të zëvendësohen me këtë përmbajtje: “Pas përfundimit të mandatit, deputeti ka të drejtë e pensionit suplementar”. Çështjet që lidhen me pensionin suplementar të deputetit, do të thotë materia e neneve vijuese, si pensioni i përkohshëm, një nen i veçantë është, pensioni për shkak të lëndimit ose paaftësisë, pensioni për shkak të rrethanave të posaçme, pensioni familjar i deputetit të vdekur, kushtet dhe procedurat për realizimin e pensionit suplementar rregullohen me akt të veçantë në përputhje me praktikat moderne demokratike dhe me specifikat shoqërore të Kosovës. Nëse më lejoni si arsyetim, deputeti ka të drejtë të ketë pensionin suplementar dhe e kanë të gjitha vendet dhe do të ishte vërtetë demagogji po të themi ne se vetëm te ne s'duhet të ketë diçka të tillë. Por, objektivisht ne nuk e kemi krijuar infrastrukturën ligjore për ta implementuar këtë zgjidhje. Prandaj, propozimi im është që të miratohet ky amendament, do të thotë që në parim të krijohet baza ligjore për rregullimin e kësaj çështjeje sipas vendeve të tjera, sipas mundësive që ka Kosova, por çështja e realizimit dhe e sanksionimit praktik të bëhet me akt të veçantë pasi të bëhen edhe hulumtimet, përgatitjet e duhura. Ju faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI:

Amendamenti 10

Komisioni për Buxhet dhe Financa,

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe 5 “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Deputetja Gjylanaze Syla, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Deputetët që kanë votuar me dorë janë “për” apo “kundër”.

Me 15 vota “për” dhe 37 “kundër” nuk miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Deputeti Ramadan Kelmendi, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Urdhëro, zoti Kelmendi!

RAMADAN KELMENDI: Faleminderit!

Amendamenti 12 është një amendament që mbështet bazën ligjore të qytetarëve, barazinë pa dallim, por duke marrë edhe sakrificën e një kategorie të qytetarëve tanë.

Dispozita e nenit 24.3 mendoj se duhet të plotësohet me dispozitën që kam paraparë 24.4: “Deputeti të cilit i njihet statusi i të burgosurit politik, koha e kaluar në burg i llogaritet si

stazh pensional në lartësinë prej 2% për çdo vit të burgut”. Kjo është analoge apo shumë e ngjashme me punën e kaluar në të gjitha segmentet e jetës së punës. Prandaj, do të ishte mirë që kjo kategori të barazohen nga fakti se dihen rrethanat nëpër të cilat ka kaluar kjo shoqëri, ky grup i qytetarëve. Ju faleminderit!

KRYETARI:

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Urdhëroni, zoti Osmani!

NASER OSMANI: ... duhet të përsëritet për të dhënë sqarime. Një tjetër ligj do ta rregullojë çështjen e burgosurve dhe do të bënim një dallim të madh mes të burgosurve që nuk janë deputetë, të cilët nuk kanë mundësi ta realizojnë këtë 2% për çdo vit. Prandaj, konsideroj që nuk është e drejtë, dhe përveç asaj, e ngarkon koston e buxhetit të këtij ligji.

KRYETARI: Megjithatë, kemi një rezultat votimi që votuam. ata që votojnë me dorë, ju lutem!

Me 27 vota “për” dhe 18 “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Është i pa objekt, deputeti Hydajet Hyseni pa përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Nuk votohet për te.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Me falni, urdhëro Agim! Më falni.

AGIM KRASNIQI: Ju Faleminderit, zoti Kryetar! Unë desha t’i japë disa vërejtje këtu. Meqë nuk jam anëtar i Komisionit dhe nuk kam marrë pjesë gjatë procedurës së amendamentimit, për të bërë ndonjë amendament të veçantë, jo për tjetër, por nuk ma ka marr mendja që neni 25 do të ndryshojë në këtë mënyrë, siç e paraqiti deputeti Ramadan Kelmendi. Unë nuk e di pse të mos jetë neni 25, ashtu si është në Projektligj, pa ndryshime, sepse nuk ka kurrfarë kuptimi që, në një mënyrë, të futen zgjedhjet presidenciale e parlamentare që kanë qenë në të ’92-ën, si zgjedhje të para po përmenden këtu, e të mos jenë zgjedhjet e ’98-ës. Kështu që jam për atë që të mbetet neni 25, ashtu siç ka qenë në Projektligj, dhe nëse jo, le ta japë sqarim dikush pse e kanë bërë në këtë mënyrë. Do të thotë, unë jam për atë që ose të jepet një sqarim për të gjithë deputetët edhe një herë, ose të mbetet neni 25 ashtu siç është në Projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Unë, eseencialisht e përkrah idenë dhe amendamentin e deputetit Ramadan Kelmendi. Vetëm se unë mendoj që është mirë që ky formulim të bëhet shumë më i sakët, më i shkurtër dhe më lapidar. Unë propozoj që ideja është e tij, e njëjta, po unë po e përsëris edhe njëherë formulimin që e kam dhënë në leximin e parë. Ky nen do të duhej të ishte kështu: “Statusi i deputetit të legjislaturave të viteve ’90-të është i njëjtë me statusin e deputetit të legjislaturave të viteve 2000.” Ky është propozimi im.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kush është për amendamentin nr. 14 me propozimin e deputetit Sabri Hamiti?

Votojmë tash:

Me 43 vota “për” dhe 26 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 15

Deputeti Hydajet Hyseni pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Amendamentet: 15, 16, 17, 18, dhe 19 kanë qenë pjesë e amendamentit të mëparshëm, di cili druaj se nuk u kuptua, siç thoshte ajo fjala: - o Zot, a nuk dita të lutem, apo nuk më kuptove. Por, megjithatë, u votua ashtu siç u votua. Uroj që të ndryshohet, por këto unë i tërheqë sepse janë të pa objekt pas asaj që u vendos, me përjashtim të amendamentit të fundit, për të cilin do ta kem fjalën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Tërhiqen amendamentet 15; 16; 17; 18; dhe 19.

Shkojmë me amendamentin nr. 20

Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Ju lutem për një sqarim dhe kërkoj falje që po më bie ta marrë fjalën kaq shpesh. Fjala është për një amendament të cilin e kam propozuar pak me vonesë, prandaj edhe është thënë në versionin e parë pa përkrahje të Komisionit. Por në mbledhjen e fundit të Komisionit, ne kemi biseduar dhe ka përkrahjen e Komisionit. Thjeshtë, është një çështje që është harruar dhe që besoj është e pakontestueshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ftoj përfaqësuesin e Komisionit ta marrë fjalën. Atëherë shkojmë në votim.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe 5 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 21

Deputetja Gjylnaze Sylja, pa përkrahjen e komisionit funksional dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Votojmë tash:

Me 18 vota “për” dhe 49 “kundër”, nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 22

Deputetja Gjylnaze Syla me përkrahjen e komisionit funksional dhe përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Votojmë tash:

Me 23 vota “për” dhe 34 “kundër”, nuk miratohet amendamenti.

Shkojmë me aprovimin e tekstit të tërësi të Ligjit bashkë me amendamentet e aprovuara. Në sallë janë 72 deputetë.

Votojmë tash:

Me 65 vota “për” dhe 6 “kundër”, aprovohet Ligji për përgjegjësitë e deputetit.

Pika e tetë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 12 korrik 2007. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet si vijon:

- **Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese,**
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe
- Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Andaj, shkojmë me aprovimin e amendamenteve me radhë.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 62 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 62 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 9 – dhe i fundit

Votojmë tash:

Me 61 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti.

Shkojmë për miratim në tërësi të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin funksioneve publike.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin funksioneve publike.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barërat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore**

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 21 qershor të vitit 2007.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet si vijon:

- Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për barërat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për barërat narkotike, substancat psikotrope dhe prekusore dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve
- Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Shkojmë me miratimin e amendamenteve një për një.

Votojmë tash:

Amendamenti 1

Me 58 vota “për” dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti.

Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, z. Kryetar!

Kemi disa ndryshime në këtë amendament. Ne na ka përcjellë gjithë kohën kjo dhe e kemi të vështirë. Amendamenti si tërësi mund të përkrahet, por paragrafi 2, ju lutem ta përqendroni vëmendjen tuaj, sugjeron zëvendësimin e shprehjes: “narkomania” me shprehjen: “sëmundje e varësisë”. Sëmundje e varësisë në gjuhën shqipe nuk ka asnjë kuptim. Do të ishte mirë së paku një sqarim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ferid Agani

FERID AGANI: Termi “narkomania” nuk është në përdorim zyrtar, në terminologjinë profesionale shkencore. Në vitet e fundit për këtë arsye kemi përdorë termin të cilin jemi duke e përdorë, i cili është edhe pjesë e klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, e kjo është sëmundje e varësisë në gjuhën shqipe. Te sëmundjet e varësisë nuk përfshihen vetëm sëmundjet nga varësia e drogave, por përfshihet edhe tabakizmi, do të thotë duhani, alkoolizmi dhe shumë substanca të tjera që krijojnë varësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Shkojmë në votim.

Amendamenti nr. 2

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 62 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 62 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 61 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Me 41 votë “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 22

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 23

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 24

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 25

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 26

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 27

Votojmë tash:

Me 48 vota “për” dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti.

Amendamenti 28

Votojmë tash:

Me 51 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 30

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 32

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 33

Votojmë tash:

Me 55 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 34

Votojmë tash:

Me 57 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 35

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 36

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 37

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti

.

Amendamenti 38

Votojmë tash:

Në sallë janë prezentë 64 deputetë.

Me 54 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 39

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 40

Votojmë tash:

Me 63 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 41

Votojmë tash:

Me 58 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 42

Votojmë tash:

Me 60 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 43

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 44

Votojmë tash:

Me 61 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 45

Votojmë tash:

Me 50 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 46

Votojmë tash:

Me 59 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti

Tash votojmë miratimin në tërësi të amendamenteve të Projektligjit.

Votojmë tash:

Me 63 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet Projektligji për barërat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët.

Tani kemi pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat

Miratimi në parim i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat, është bërë më 19 dhjetor 2005.

Komisioni funksional për Arsim e ka shqyrtuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin që projektligji t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

A dëshiron ndokush fjalën, lidhur me këtë?

Nëse nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është për rekomandimin e Komisionit?

Votojmë tash:

Me 54 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet rekomandimi i komisionit funksional.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për kthimin në ripunim të Projektligjit për punë; të Projektligjit për grevat dhe të Projektligjit për organizimin sindikal

Pra, i kemi tri projektligje të cilat propozohen t'i kthehen Qeverisë.

Miratimi në parim i Projektligjit për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal, është bërë më 19 dhjetor 2005, i Projektligjit për grevat më 24 qershor 2005 dhe i Projektligjit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale është bërë më 16 tetor 2006.

Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, i ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandim që të tri projektligjet t'i kthehen Qeverisë në ripunim.

Lus deputetët, të cilët nuk janë në sallë, të kthehen sa më shpejt dhe të votojmë.

Tani në sallë janë 61 deputetë, prandaj mund të votojmë.

Kush është për rekomandimin e Komisionit?

Votojmë tash:

Me 53 vota “për” dhe asnjë “kundër”, miratohet propozimi i Komisionit.

Tani është pika e fundit e rendit të ditës – pika e trembëdhjetë:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore

Sipas nenit 4.8 të Ligjit për trashëgiminë kulturore, Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore emërohet nga Kuvendi i Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve, me mandat trevjeçar.

Në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit për trashëgiminë kulturore, Komisioni për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport, pas shqyrtimit të propozimit nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, vendosi që Kuvendit t’i rekomandojë emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.

Rekomandimi i Komisionit, bashkë me listën e kandidatëve, u është shpërndarë deputetëve.

A dëshiron kush ta marrë fjalën në emër të Komisionit?

Nuk qenkan këtu as kryetari, as nënkryetari i Komisionit.

Me këtë rast, lus deputetët të kthehen në sallë për ta kryer procedurën e votimit.

Në sallë janë 60 deputetë.

Tani, në sallë janë të pranishëm 62 deputetë.

E hedh në votim rekomandimin e Komisionit

Kush është për?

Votojmë tash:

Me 52 vota “për” dhe 4 “kundër”, miratohet rekomandimi i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.

Me kaq, përfundoi punën seanca e sotme plenare.

Mirupafshim, në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripeve e Kuvendit të Kosovës